



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 51/09

Prishtinë, më 25.05.2009, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Besa Gaxherri dhe Müfera Şinik.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Riza Smaka, Shkumbin Demaliaj dhe Xhevdet Neziraj.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Ahmet Shala** Ministër i MEF-it, **Agim Krasniqi** Drejtor i Buxhetit pranë MEF-it, **Kosum Aliu** Drejtor i NJQH-së, **Përfaqësuese nga Zyra për Komunitete dhe nga Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur, Teki Shala** nga NDI, **monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, ICO, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e dt. 6.05.2009 dhe 8.05.2009;**
- 3. Shqyrtim i propozim - amendamente plotësuese lidhur më Projektligjin për partneritet publiko – private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/2171/ Ra -013 dt. 14.05.2009 për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshme në sektorin publik të Kosovës për vitin 2008;**
I ftuar : Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa;
- 5. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/62 dt. 30.4.2009 lidhur me kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 – 2012;**

6. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për sigurimin e kushteve të punës së KKTK-së, dt 31.03.2009;
7. Shqyrtimi i propozimi - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/49 dt. 09.01.2009 për lejimi e stafit shtesë në Zyrën për Komunitete që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit,
Të ftuar : Përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit;
8. Shqyrtimi i propozimi – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 08/47, dt. 12.12.2008 për lejimi e stafit shtesë në Komisionin Qeveritar për Personat e Pagjetur,
Të ftuar : Përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit;
9. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat sendore, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Safete Hadërgjonaj, propozoi që për shkak të agjendës së ngjeshur të komisionit, të mbahen më shumë mbledhje dhe rendi ditës të jetë më pak i ngarkuar.

Rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e dt. 6.05.2009 dhe 8.05.2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhjet e kaluara dt. 6.05.2009 dhe 8.05.2009, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtim i propozim - amendamente plotësuese lidhur më Projektligjin për partneritet publiko – private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre

Kryesuesi, theksoi pas tërheqjes së raportit, në bashkëpunim me zyrtarët e MEF-it dhe me Zyrën e USAID-it kemi bërë disa modifikime të amendamenteve. Kërkoj mbështetjen e komisioni për këto amendamente dhe në këtë mënyrë raporti të procedohet për miratim.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, theksoi se me amendamentet plotësuese është bërë një gjuhë më e qartë. Ndryshimi i nënpikës d, të paragrafit 11.2, ka qenë i domosdoshëm, për arsye se nuk do të ishte reale që bordi të udhëhiqej nga Ministri i MEF-it, ndërsa të raportoj zëvendëskryeministri. Kërkoj që komisioni të mbështet aprovimin e këtyre amendamenteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me tetë vota Për, asnjë Kundër dhe një Abstenim (Znj. Besa Gaxherri) Komisioni nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Miratohen propozim-amendamente plotësuese lidhur më Projektligjin për partneritet publiko – private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre.
- II. Projektligji për partneritet publiko – private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre, me amendamente, të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/2171/ Ra - 013 dt. 14.05.2009 për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshme në sektorin publik të Kosovës për vitin 2008

Kryesuesi, vlerësoi raportin mirë të përgatitur. Nga raporti shifet se disa nga rekomandimet e komisioni nga monitorimi i ligjit janë respektuar. Në problemet me auditimin e brendshëm, edhe pse pengesë në këtë drejtim ka paraqitur ligji, por në disa raste është konstatuar se jo gjithmonë është shkaktar ligji për parregullsitë që ndodhin në sistemin publik të auditimit të brendshëm.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, theksoi se i kemi pasur parasysh vërejtjet dhe rekomandimet e komisionit. Ministria e Ekonomisë dhe Financave po e ushtron ndikimin e vet në përmisimin gjendjes së sistemit të auditimit të brendshëm. Për më tepër shpjegime për raportin ia dha fjalën drejtorit të NJQH-së.

Kosum Aliu, theksoi se raporti paraqet gjendjen ekzistuese në sistemin e auditimit në sektorin publik. Janë pasqyruar të dhënat për implementimin e rekomandimeve nga organizatat buxhetore, ato që janë në proces të implementimit dhe që ato nuk janë implementuar. Për problemet në sistemin e auditimit të brendshëm pengesë ka paraqitur baza ligjore, që është shtruar nevoja për harmonizim me praktikat ndërkombëtare, por edhe gjendja në teren. Mirëpo me trajnimet e bëra kemi arritur të ndërtojmë një sistem më efikas për çka edhe kemi lëvdata nga mekanizmat ndërkombëtar. Në këtë drejtim ndihmë të veçantë ka dhënë Komisioni për Buxhet dhe Financa, me rekomandimet e nxjerrur nga monitorimi i ligjit. Duke pasur parasysh faktin se është raporti i parë, nuk janë dhënë të dhëna krahasuese.

Myrvete Pantina, vlerësoi raportin përmbajtësor përmes së cilit shihet gjendja e auditimit të brendshëm në sistemin publik në Kosovë. Ndër problemet që përballet sistemi i auditimit janë, numri i pamjaftueshëm i auditorëve, ikja e tyre nga sektori publik, mosrespektimi i pagës për auditorët, moskompletimit i Njësitë të Auditimit me auditor të mjaftueshëm nëpër organizata buxhetore. Një çështja tjetër brengosëse është mosrespektimi i një numri të madh të rekomandimeve nga organizatat buxhetore. Në këtë drejtim do të duhej të kërkonte masa konkrete për implementimin e këtyre rekomandimeve. Përndryshe përkrahu miratimin e raportit.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi raportin mirë të përgatitur, i cili pasqyron gjendjen e sistemit të auditimit të brendshëm në Kosovë. Elemente që kërkohej me ligj janë përfshirë në këtë raport. Pasi jemi në proces të amendamentimit dhe miratimit të Ligjit të ri, kërkoj që MEF-i në bashkëpunim me grupin punues të komisionit të punojnë që të rregullohet çështjen e auditimit të ndërmarrjeve publike.

Besa Gaxheri, theksoi se nga raporti shifet se gjendja e auditimit në sektorin publik nuk është edhe aq e mirë. Njësitë e Auditimit nuk funksionojnë, pastaj kushtet e auditorëve janë mjerueshme. Një problem tjetër është moskordinimi i punëve në mes NJQH-së dhe MEF-in. Përkundër se kornizën afatmesme të shpenzimeve 2010-2012 shifet se nuk do të ketë ngritje të pagave, për të kërkuar përgjegjësi dhe llogaria më të madhe ndaj auditorëve, duhet përmisuar kushtet e tyre. Shqetësuese paraqet fakti i mospërfilljes së rekomandimeve të komisionit nga MEF-i. Kërkoj që të kompletohet legjislacioni dhe sistemi i auditimit në sektorin publik të funksionoj në bazë të ligjit.

Kosara Nikolić, vlerësoi raportin mirë të përgatitur. Megjithatë shifet se ka nevojë për përmisim të gjendjes së auditimit në sektorin publik. Në këtë drejtim në Njësitë e Auditimit të Brendshëm, duhet të punësohen dhe të trajnohen më shumë auditor nga radhët komuniteteve pakicë.

Kryesuesi, duke u ndërlidhur në diskutimet, theksoi se auditorët e brendshme kane pasur paga me te mira se auditorët e jashtëm. Kërkoj që të insistohet në respektimin e rekomandimeve nga

organizatat buxhetore. Po ashtu do të ishte mirë që në raport për secilën njësi buxhetore të bashkëngjiten implementimi i rekomandimeve të tyre.

Kosum Aliu, ne përgjigjen e pyetjeve, theksoi se ikja e auditorëve kane ndodhur për shkak të pagave dhe ata kane shkuar kryesisht në ndërmarrjet publike dhe bankat private. Po përiqemi përmes trajnimeve të mbajmë. Raportet me auditorin e jashtëm janë më të mira se më parë dhe ata disponojnë raportet tona. Sa i përket implementimit të rekomandimeve, ato janë në proces të përmbushjes nga organizatat buxhetore.

Pasi që vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të miratojë Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshme në sektorin publik të Kosovës për vitin 2008.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/62 dt. 30.4.2009 lidhur me kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 – 2012

Kryesuesi, në bazë të ligjit Qeveria dorëzon në Kuvend KASH-in në Kuvend, e cila shërben si bazë orientuese në përgatitjen e buxhetit. Për të dhënë informacionet shtesë rreth kësaj ia dha fjalën drejtorit të buxhetit.

Agim Krasniqi, theksoi se KASH është një dokument i politikave që shërben si bazë orientuese në përgatitjen e buxhetit. Ai është i ndarë në katër kapituj, sektor prioritar gjatë kësaj periudhe mbesin ato që kanë qenë (arsimi, shëndetësia, bujqësia, infrastruktura, energjia, sundimi i ligjit dhe rendit). Kriza financiare nuk ka pasur ndikim direkt negativ në Kosovë, por efektet negative ekonomike rrezikojnë edhe ekonominë e vendit tonë. Prandaj jemi munduar të ruajmë qëndrueshmërinë fiskale dhe ekonomike. Rritja e GDP-së parashihet të jetë 5.1. Gjithashtu është parashikuar rritje të granteve për komunat. Dokumenti nuk është final, gjatë periudhës që lejon edhe ligji, ajo do të rishikohet dhe modifikohet duke iu përshtatur rrethanave ekonomike. Në këtë drejtim efekte pozitive në buxhetin e Kosovës mund të ketë edhe anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar financiar.

Kosara Nikolic, theksoi se Ministria për Komunitete nuk është përfshirë në kornizën afatmesme, dhe bëri pyetje se a është menduar se do të përfshihet në procesin e decentralizimit. Nëse është menduar për këtë, konsideroi se ajo duhet të përfshihet në kornizën afatmesme, në të kundërtën nuk është mirë për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Myrvete Pantina, nga përmbajtja e Kornizës shifet se edhe në këtë periudhë nuk mund të jemi optimist, përkundër nevojave tona. Shifet se struktura ekonomisë është e njëjtë, dominon tregtia, të hyrat nga doganat. Vërejtje bëri për shkak të mungesës së strategjisë së zhvillimit. Kemi nevojë për një strategji të këtillë, që në afate të përcaktohen prioritetet, shkalla e tyre, që të mund të shikojmë realizimin e tyre. Është dashur që në tregun e punës të cekën kapacitetet gjeneruese, që të shohim qfarë ka ndodhur me papunësinë. Gjithashtu të shikohet tërheqja e profesionistëve apo pengimi i ndaljes së tyre. Mungesa e të dhënave për ekonominë joformale ka reflektime në bazën tatimore.

Besa Gaxherri, theksoi se kemi të bëjmë me një dokument parashikues nga i cili shifet se nuk kemi përpjekje serioze të Qeverisë për të bërë ndryshime. Nëse analizojmë prioritetet, rasti i energjisë, shifet se përkundër mjeteve të ndara për KEK-un nga Kuvendi, ato nuk janë shpenzuara. Nga kjo që shifet, nuk të jep shpresë se energjia do të jetë fusha e zhvillimit ekonomik. Është e papranueshme

që buxheti gjatë kësaj periudhe është parashikuar të rritet vetëm 20%. Po të luftohej ekonomia joformale, korrupsioni, parashikimet do të ishin që buxheti të jetë dyfish më i madhë. Nuk do të ketë rritje pagash. Si mund të funksionoj mirë administrata publike, policia, drejtësia, shëndetësia nga paga e mjerueshme që do ti kenë. Qfarë reforme mund të bëhet në administratën publike me këto kushte.

Hajdin Abazi, vlerësoi parashikimet buxhetore si të matura, gjë që tregon se duke pasur parasysh krizën financiare botërore, ruhet gjendja stabile buxhetore. Si rezultat i kësaj krize shumë shtete kanë ulje të ekonomisë, ndërsa tek ne parashihet rritje buxhetore, gjë që është për tu vlerësuar. U pajtua me propozimin që strategjia e zhvillimit të jetë dokument plotësues. Në këtë drejtim të bëhen përpjekje që ekonomia joformale të futet nën kontroll, e që do të ketë refleksione pozitive buxhetore. Megjithatë u shpreh optimist se me anëtarësimin e Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare dhe nga investimet nga jashtë, këto parashikime mund të ndryshojnë dhe të lëvizin në drejtim më pozitiv.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi punë të mirë dorëzimin Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve nga MEF-i, në mënyrë që të mund të merremi më gjatë me procesin buxhetor. Jemi mësuar të miratojmë buxhetin pa i pasur treguesit makro-ekonomik, të dhënat sektoriale, prioritet, ndërsa tani kemi materialin, që na mundëson të japim propozime, sugjerime konkrete, por duke u bazuar në fakte dhe gjendjen reale ekonomike dhe jo në dëshira.

Kryesuesi, theksoi se shqyrtimi i KASH-it është praktikë e re. Parashikimet janë dhënë në bazë të parametrave, në mungesë të të dhënave dhe treguesve matës, nuk mund të bëhen parashikime të sakta, të konstatohet rritja e GDP apo të konstatojmë për shkallën e ekonomisë joformale. Të përqendrohemi në prioritetet dhe projektet e parapara, dhe duke pasur parasysh rrethanat e brendshme për të bërë projeksionet buxhetore, të propozojmë apo sugjerojmë ndryshime eventuale.

Besa Gaxherri, vlerësoi se në mungesë të të dhënave të mjaftueshme për projektet e prezantuara në Kornizë, nuk mund sugjerojmë se cili projekt apo sektor duhet të jetë prioritar dhe më i mirë për ekonominë e vendit.

Agim Krasniqi, theksoi se është dokument i politikave do të operacionalizohet me miratimin e buxhetit. Ministria për Komunitete është brenda sektorëve tjerë, duke u përfshirë edhe në pjesën e decentralizimit. Sa i përket pagave me Ligjin për paga dhe shërbyesit civil rregullohen këto çështje. Janë parashikuar prioritetet, nuk është menduar të shkohet në projekte individuale. Për të dhënat e prezantuara janë bërë vlerësime në bazë të indikatorëve matës ekzistues. Me anëtarësimin e Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare, shpresojmë në ndërrimin e qasjes pozitive edhe në projeksionet buxhetore. Presim rekomandimet e Kuvendit që do të merren parasysh me rastin e përgatitjes së buxhetit.

Pasi që vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare, të shqyrtoj Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2010-2012.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për sigurimin e kushteve të punës së KKTK-së, dt 31.03.2009

Kryesuesi, theksoi se kërkesa nuk është e precizuara, do të duhej të kthehej prapa që të plotësohet konform ligjit dhe e njëjta të procedohet për Kuvend në fazën e rishikimit buxhetor.

Kosara Nikolic, u ankua se nuk e ka marrë materialin në gjuhën e serbe.

Kryesuesi, duke iu përgjigjur parafolëses theksoi se kjo është një detyrë e shërbimit të administratës, e cila nuk duhet t'i pranoj materialet e pakompletuara.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë që kërkesën e tyre buxhetore të hartojnë në përputhje me Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe të njëjtën ta dërgojnë në Kuvend për shqyrtim, gjatë fazës së rishikimit të buxhetit të vitit 2009.

7. Shqyrtimi i propozimi - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/49 dt. 09.01.2009 për lejimi e stafit shtesë në Zyrën për Komunitete që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit

Kryesuesi, theksoi se kërkesa nuk është parashtruar për shqyrtim konform bazës ligjore. Kërkohej rritja e numri të punëtorëve ndërsa nuk tregohet se prej cilit burim financiar merren mjetet, sa është ndikimi buxhetor, në cilën kategori ekonomike merren mjetet dhe në të cilën barten. Prandaj në mungesë të bazës ligjore, komisioni nuk mundet të nxjerr rekomandim. Do të kërkohej plotësimi i kërkesës në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe Ligjit për Buxhetin 2009.

Safete Hadërgjonaj, mbështeti mendimet e kryesuesit dhe thekoi se është e papranueshme si janë proceduar kërkesat në Kuvend. Arsyeshmëria e kërkesës mund të diskutohet në bazë të materialit të kompletuar. Kërkoj që të njëjtat të kthehen mbrapa për plotësim.

Besa Gaxherri, duke u ndërlidhur, theksoi se ne jemi kompetent të analizojmë edhe arsyeshmërin dhe të japim vendimin për kërkesën e caktuar.

Zahir Bajrami, theksoi se ne nuk jemi kompetent për pjesën e përgatitjes së kërkesës. Prandaj komisioni të bëjë rekomandimin me shkrim, që kërkon plotësimin e saj

Agim Krasniqi, propozoi që kërkesat të propozohen në fazën e rishikimit sepse nuk mund të ketë rritje të numrit të punëtorëve.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Të kompletohet kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për lejimi e stafit shtesë në Zyrën për Komunitete, në bazë të Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, dhe e njëjta të procedohet për shqyrtim në Kuvend

8. Shqyrtimi i propozimi – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 08/47, dt. 12.12.2008 për lejimi e stafit shtesë në Komisionin Qeveritar për Personat e Pagjetur

Kryesuesi, theksoi se kemi të bëjmë me të njëjtin rast, sikurse me kërkesën e parë, prandaj do t'i kthehet Qeverisë për plotësim konform dispozitave ligjore.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Të kompletohet kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për lejimi e stafit shtesë në Komisionin Qeveritar për Personat e Pagjetur, në bazë të Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, dhe e njëjta të procedohet për shqyrtim në Kuvend.

9. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat sendore, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rishqyrtuar Projektligjin për të Drejtat Sendore dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

10. Të ndryshme

Kryesuesi, bëri vërejtje anëtarëve të cilën nuk i përgjigjen orarit të punës së mbledhjeve dhe takimeve të komisionit, siq ishte rasti i takimit me nënkomisionin e Parlamentit Finlandez.

Gjithashtu kryesuesi njoftoi me raportin tre mujor të Qeverisë për buxhetin 2009 dhe raportin tremujor të Kuvendit 2009, dhe duke pasur parasysh se është afër raporti gjashtëmujor, kërkoi të deklarohen se a të futen për diskutim në komision.

Besa Gaxherri, theksoi se Ligji thotë se duhet të shqyrtohen. Ndërsa mendimin e saj me këtë propozim do ta jap në votim.

Kryesuesi, njoftoi se kemi një kërkesë nga Kryeministri për përsheptimin procedurave për miratimin e Ligjit për anëtarësimin Kosovës në FMN. Duke ditur rëndësinë e këtij Ligi kërkoi nga anëtarët të deklarohen se komisioni përkrah miratimin e tij në parim.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në leximin e parë të miratojë në parim Projektligjin nr.03/L-152 për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Safete Hadërgjonaj, njoftoi se si kryesuese e grupi punues për amendamentimin e Projektligjit të Auditmit të Brendshëm ka caktuar një takim i cili nuk është mbajtur për shkak se anëtarët grupit punues, nuk iu janë përgjigjur takimit. Njoftoi se javën e ardhshme do të mbahet takimi tjetër, në të cilin do të ftohen edhe përfaqësuesit e MEF-it.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI